

FOL

NDIKIMI I STRATEGJIVE SEKTORIALE NË MJEDIS

MARS 2021

Publikuar nga Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e Lëvizjes FOL që është përgjegjëse për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

PËRMBAJTJA

1	Akronimet
2	Përmbledhje Ekzekutive
5	Metodologjia e analizës
6	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025
12	Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010 – 2020
15	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017 – 2026
20	Strategjia e Republikës së Kosovë për Menaxhimin e Mbeturinave 2013 – 2022
25	Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013 – 2022
32	Përfundimet e Analizës

AKRONIMET

AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
DP	Departamenti i Pylltarisë
EE	Efiçienca e Energjisë
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë/Food and Agriculture Organization
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatorët Ekonomik
SCA	Strategjia për Cilësinë e Ajrit
SERK	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës
SMRK	Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës
SRKMM	Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
SZHP	Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë
TC	Termocentrali

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mjedisi është njësi natyrore e përbërë nga gjithë njërëzit, bimët, kafshët dhe mikroorganizmat në një zonë që funksionon së bashku me të gjithë faktorët tjerë fizikë jo të gjallë. Të gjitha veprimet e njerëzve, sektoreve të ekonomisë, apo shtetit shkaktajnë ndikim në mjedis. Meqë mjedisi nuk njihet kufi, përpjekja për mbrojtjen e tij shpesh është konsideratë ndërkombëtare, dhe jo vetëm preokupim vendor. Si e mirë e përbashkët, mjedisi duhet të shfrytëzohet në mënyrë racionale dhe të qëndrueshme, me qëllim që të mund t'i trashëgohet në gjendje të mirë edhe brezave të ardhshëm. Andaj, si i tillë, vlera e mjedisi matet në perspektivë afatgjate.

Kosova, si vend në zhvillim, ka nevojë për ndërtim të ekonomisë, infrastrukturës, prodhim të energjisë, etj. Krahas zhvillimit, Kosovës i duhet edhe të menaxhojë mirë me resurset natyrore (lumenjtë, mineralet dhe pyjeve), dhe të menaxhojë rritjen e vazhdueshme të mbeturinave dhe emetimeve të gazrave të ndryshme në ajër. Gjitha këto aktivitete duhet të bëhen në mënyrë të kontrolluar në mënyrë që të mos shkaktohen efekte negative në mjedis por të sigurohet mirëqenie e popullatës, dhe mbrojtje e shëndetit të tyre. Sfidë më e madhe me të cilën ballafaqohet Kosova në këtë drejtim është balancimi i zhvillimit të tanishëm, me ruajtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm.

Orientimi i politikave të cilitdo sektor bëhet përmes strategjive afatgjata të cilat zakonisht nuk synojnë vetëm zhvillimin, por synojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm në thelb ka shfrytëzimin e resurseve. Resurse janë të shterrshme, dhe nuk janë të shpërndara njësoj. Andaj, ato duhet të menaxhohen brenda kufizimeve të parapara me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet tjera strategjike që orientojnë politikat publike.

Kjo analizë shqyrton ndikimin në mjedis të pesë strategjive:

- 1) Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012–2025,
- 2) Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010–2020,
- 3) Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017–2026,
- 4) Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013–2022, dhe
- 5) Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013–2022.

Edhe pse dallojnë në cilësi dhe format, këto Strategji sektoriale në Kosovë përgjithësisht janë të vetëdijshme për ndikimin që aktivitetet e sektorëve të ndryshëm kanë në mjedis. Pesë strategjitë sektoriale përfshijnë gjuhë dhe objektiva që synojnë të mbrojnë mjedisin. Mirëpo, në praktikë, përvoja tregon se ky synim fillon dhe mbaron në letër. Masat e parapara për të jetësuar objektivat që Strategjitë kanë për mbrojtjen e mjedisit shpesh nuk gjejnë financim dhe zbatim. Mjedisit si sektor është lënë kryesisht në duar të projekteve të donatorëve dhe në mëshirën e asistencës zhvillimore.

Analiza shpërfaqë faktin se Kosova është duke u ballafaquar me dëme të mëdha mjedisore si rezultat i: legjislacionit burokratik që në fund përfundon i pazbatuar, mungesës së bashkëpunimit ndër institucional, abuzimit me leje dhe licenca për shfrytëzim, ambicjes së shfrenuar të OE-ve për ta maksimizuar profitin në dëm të ambientit, dhe dështimit të institucioneve për t'i monitoruar dhe sanksionuar veprimet e tilla të dëmshme për mjedis dhe të mirën e përgjithshme. Shpesh, institucionet zgjedhin të mos bëjnë asgjë me arsyetimin e mungesës së buxhetit. Kështu ato dështojnë së parandaluari rrjedhjen edhe më të madhe buxhetore që shkaktohet si pasojë e rrezikimit të shëndetit të qytetarëve dhe degradimit të mëtutjeshëm të mjedisit.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012–2025 ka ende kohë të mbetur për zbatim. Institucionet përgjegjëse duhet të përmirësojnë bashkëpunimin mes tyre në mënyrë që të parandalojnë aktivitetet ilegale dhe degradimi aktual që i bëhet mjedisit

në vazhdimësi. Përpos dështimit të mbrojtje mjedisin, kjo Strategji deri më tani nuk ka arritur as objektivën e saj kryesore të valorizimit dhe vënjes së mineraleve në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010–2020 tanimë ka skaduar. Qeveria është në proces të vlerësimit nëse ajo i ka përmbushur objektivat e saja. Në praktikë, situata me prerjet ilegale të drunjëve dhe shkatërrimin e pyjeve, tregon se ky dokument 10 vjeçar, në rastin më të mirë është realizuar vetëm pjesërisht. Pasojat kryesore e të drejtëpërdrejta të veprimeve që do të duhej të parandaloheshin si rezultat i kësaj Strategjie janë: degradimi i tokës pyjore, erozioni, zvogëlimi i emetimit të oksigjenit, shkatërrimi të biodiversitetit, rritja të rrezikut nga përmblytjet dhe zjarret pyjore.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017–2026, mbështetet në mënyrë të theksuar në planin për ndërtimin e një termocentralit të ri. Me dështimin e atij projekti, rishikimi i kësaj Strategjisë është nevojë e kohës. Strategjia e re duhet të jetë mjaftueshëm ambicioze për të akomoduar caqet e Kosovës për efqiencë të energjisë dhe për burime të ripërtitshme të energjisë.

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013–2022 ka vetëm edhe një vit të mbetur. Edhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës e konsideron përmbushjen e kësaj Strategjie si vetëm të pjesshme. Përgjatë periudhës së mbuluar nga Strategjia, situata në këtë sektor është përkeqësuar edhe më tej. Kosova ka nevojë për ngritjen e sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim – Riciklim - Djegie - Deponim).

Strategjia e Cilësisë së Ajrit 2013–2022 ka vetëm një vit të mbetur. Përgjatë periudhës së mbuluar nga kjo Strategji, situata në këtë sektor është përshkallëzuar. Për ta parandaluar trendin momental të ajrit të ndotur me të cilin ballafaqohet Kosova tash e sa vite, nevojitet rishikim rrënjësor dhe planifikim i qëndrueshëm i shumë sektorëve (energjisë, transportit, industrisë amvisërisë), dhe vetëdija më e lartë kolektive.

Në shumicën e rasteve, raportet e monitorimit të zbatimit të këtyre Strategjive nuk janë dokumente të publikuara në webfaqe, dhe si të tilla nuk janë lehtë të qasshme për publikun. Mungesa e tillë e transparencës pengon llogaridhënjen, dhe zvogëlon mundësitë që qytetarët t'i mbajnë përgjegjës institucionet për (mos) veprimet e tyre.

METODOLOGJIA E ANALIZËS

Analiza është realizuar me metodë të përzier. Për secilën strategji, fillimisht është analizuar pjesës narrative dhe janë shqyrtuar në mënyrë të përgjithësuar edhe anekset tjera, pjesë të këtyre strategjive. Aty ku ka qenë e aplikueshme, janë analizuar edhe raportet e progresit të zbatimit.

Analiza përfshinë edhe intervista me zyrtarët e institucioneve përgjegjëse për sektorët e analizuar. Kontributi i përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse mbi zbatimin e strategjive është marrë përmes komunikimit virtual, duke evituar kontaktet për shkak të pandemisë COVID-19. Aty ku ka qenë e aplikueshme, kjo analizë i referohet edhe raporteve dhe punimeve të organizatave jo-qeveritare apo multilaterale të cilave trajtojnë fushat në fjalë.

Analiza e secilës strategji fokusohet në misionin, parimet udhëheqëse, objektivat, dhe masat e parapara për ngritjen dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Kjo analizë adreson edhe çështjet tjera të ndërlidhura, nëse ato kanë ndikim në mjedis. Përpos analizës së strukturës së strategjisë, ky dokument gjithashtu fokusohet në institucionet përgjegjëse, si dhe sfidat dhe pengesat e hasura gjatë zbatimit. Në fund, jipen përfundime të përgjithësuara lidhur me atë se a janë arritur objektivat e strategjisë në fjalë apo jo.

Vlenë të ceket se secila nga pesë strategjitë e analizuara ka më shumë se një objektivë me ndikim në mjedis. Mirëpo, për qëllime të fokusimit të analizës, ky dokument trajton vetëm objektivën e cila ka si synim kryesor/të vetëm mbrojtjen dhe parandalimin e ndikimit në mjedis.

STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2012 – 2025

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012–2025 (SMRK), është hartuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (tani Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit). Një pjesë e madhe e tekstit të SMRK i dedikohet identifikimit të mineraleve dhe shpjegimit të karakteristikave të tyre. Për më tepër, SMRK gjithashtu përmbanë vendodhjen apo koncentrimin e mineraleve energjetike, metalore, jo-metalore dhe materialeve ndërtimore të Kosovës.

Kosova është ndër shtetet me rezerva të konsiderueshme minerare të cilat paraqesin rëndësi të madhe ekonomike për vendin. Mineralet e Kosovës ndahen në dy grupe. Në grupin e parë përfshihen pasuritë minerare të cilat ndodhen në sasi/rezerva të mëdha gjeologjike, si: qymyri, mineralet e plumbit-zinkut, nikelit-kobaltit, magnezit, kromit, aluminit, betonitet dhe kaolini. Në grupin e dytë përfshihen pasuritë minerale dhe metalore, mjaft të përhapura, që mund të përdoren si materiale për ndërtim dhe industri, si: argjilet, asbesti, leucitet, haloizitet, dunitet, betonitet, etj. Shfrytëzimi i ‘qëndrueshëm’ i këtyre pasurive shihet si prioritet i vendit.

LINJIT (miliardë ton)	PLUMB, ZINK (miliardë ton)	NIKEL (miliardë ton)	BOKSITET (miliardë ton)	MAGNEZITET (miliardë ton)
12.4	58.7	13	2.7	3

Tabela 1. Rezervat minerare kryesore

Edhe pse konsideratë primare e SMRK-së është vënja në fuksion e pasurive në dobi të zhvillimit ekonomik, deklatarivisht shfrytëzimi i resurseve minerare parashihet të bëhet në mënyrë të qëndrueshme dhe në harmoni me mjedisin. Në letër, SMRK duket mjaftueshëm e vetëdijshme për mjedisin, dhe përmbanë gjuhë të qëllimshme dhe adekuate për parandalimin e efekteve negative që mund të shkaktohet në të.

¹ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), Faqja zyrtare: <https://www.kosovo-mining.org>. Qasur më 14 mars 2021. Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Në përmbledhjen ekzekutive të SMRK për periudhën 2012–2025 thuhet se ky dokument krijon mundësi reale për shfrytëzim sa më racional dhe zhvillim të qëndrueshëm të resurseve minerare. Ndërsa, qëllimi primar i kësaj strategjie 44 faqëshe, është: ‘të krijojë kushtet për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit mineral, i cili kontribuon në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës’.

Parimet udhëheqëse për zbatimin e Strategjisë Minerare thuhet të jenë:

1. Të ofrojë përfitime afatgjata ekonomiko-sociale për Kosovën;
2. Kontibujë në arritjen e objektivave zhvillimore ekonomike;
3. Të punojë për mbrojtjen e mjedisit dhe të minimizojë efektet negative;
4. Të mundësojë tërheqjen e investimeve të reja në sektor.

Me të drejtë, efektet negative mjedisore janë një ndër dobësitë e identifikuar në SMRK, në pjesën e analizës SWOT. Një dobësi tjetër është edhe infrastruktura jo e mjaftueshme ligjore dhe rregullative, e cila edhe tani, vite më pas, mbetet mjaft e brishtë. Mungon edhe harmonizimi në mes të dokumenteve strategjike shtetërore, dhe mbi të gjitha monitorimi i tyre proaktiv dhe i vazhdueshëm (për më shumë detaje shih tekstin më poshtë). Si pasojë, pavarësisht asaj që është e shkruar në letër, në praktikë, dëmet e shkaktuara në mjedis nga nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve janë të pa-riparueshme. Kjo jo vetëm për shkak të ndërhyrjeve që presupozohen në rastet e aktiviteteve minerare, por sidomos për shkak të tendencës së operatorëve ekonomik (OE) për maksimizim të profitit.

² Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Dokumenti vlerëson se gjendja aktuale e sektorit minerar nuk mundëson arritjen e qëllimit primar të SMRK për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit në funksion të mirëqenjes së qytetarëve. Prandaj ai parasheh reformim dhe ristrukturim të sektorit minerar bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfitimit maksimal të shoqërisë dhe shtetit nga shfrytëzimi i resurseve minerare.

SMRK bazohet në katër shtylla themelore të cilat në vetvete përmbajnë objektiva, politika zhvillimore dhe veprime. Katër shtyllat themelore të kësaj strategjie janë:

Shtylla 1 - Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzimin dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve.

Shtylla 2 - Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin minerar.

Shtylla 3 - Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit.

Shtylla 4 - Përkujdesja për mjedisin.

Siç shihet, shtylla e katërt e thekson si shumë të rëndësishme mbrojtjen e mjedisit dhe garanton marrjen e masave të nevojshme për minimizimin e ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti minerar. Kjo shtyllë parashah 2 Objektiva konkrete dhe një sërë Masash.

Objektiva 1: Zgjidhja e problemve mjedisore historike - ka të bëjë me detyrimet mjedisore historike të cilat janë rezultat i punës së shfrytëzimit të linjitet dhe gjenerimit të energjisë elektrike në vend si dhe rezultat i punës shumëvjeçare të mineraleve metalurgjike të Trepçës, nën të cilën parashihen 5 masa konkrete.

Objektiva 2: Mbrojtja e mjedisit nga aktiviteti minerar - ka të bëjë me mbrojtjen dhe menaxhimin e rehabilitimit të mjedisit pas eksploatimit të mineraleve nga subjekti i licencuar, dhe obligimi për konsultim me komunitetin dhe grupet e interesit, nën të cilën parashihen 7 masa konkrete. ³

³ Se sa prej këtyre mesave janë zbatuar, zyrtarët e MEA-s nuk janë përgjigjur në pyetjet e dërguara. Pyetjet janë adresuar te Skender Sallahi, Drejtor i Departamentit të Minierave më 24 shkurt 2021 dhe 12 mars 2021.

Menaxhimi, licencimi dhe monitorimi i veprimeve që parashihen në këtë Strategji bëhet nga institucionet kompetente të sektorit minerar në Kosovë:

- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA)
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)
- Institucionet tjera që lidhen me sektorin minerar (Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Pyjore e Kosovës, Komunitat, etj.)

Procesi i pajisjes me licencë dhe leje mjedisore është përgjegjësi e dy institucioneve dhe si i tillë presupozon bashkërendim të ngushtë mes tyre. Fatkeqësisht, një gjë e tillë mungon, në dëm të mjedisit, dhe në dëm të buxhetit të shtetit. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga raporti i auditimit të performancës nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ku thuhet se KPMM si një nga institucionet kryesore në vend për këtë sektor, nuk ka koordinim me MEA, si hartuese dhe përgjegjëse e strategjisë minerare. Licencat për hulumtim dhe shfrytëzim jipen nga KPMM, ndërsa pëlqimet dhe lejet mjedisore janë përgjegjësi e MEA, në bashkëpunim me inspektoratet e niveleve qendrore dhe lokale. Një OE që synon të zhvilloj aktivitet për shfrytëzimin e mineraleve duhet të ndjekë një proces katër hapësh për tu pajisur me licencë për shfrytëzim: 1) nga KPMM të pajiset me licencë hulumtuese; 2) nga MEA pajiset me pëlqimin mjedisor; 3) nga KPMM pajiset me licensë shfrytëzuese; 4) nga MEA pajiset me leje mjedisore. Shpesh OE ndjekin vetëm tre hapat e parë, dhe si të tillë operojnë vetëm me pëlqim mjedisor, por pa leje mjedisore. Një gjë e tillë shkakton çrregullime dhe abuzim me resurse dhe me mjedis të përgjithshëm, për interesa të ngushta të disa palëve.

Si e tillë, Kosova duhet të rishikojë kornizën ligjore që aktualisht mundëson KPMM-në të jep licenca dhe leje për shfrytëzim vetëm me pëlqimin mjedisor të lëshuar nga MEA. Në praktikë, pas dhënies së licencës, KPMM nuk i përcjellë OE-të nëse ato pajisen me leje mjedisore para se të fillojnë punën, apo gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar edhe pse korniza ligjore për mbrojtjen e ambientit parasheh edhe plotësimin e kriterit për

leje mjedisore para fillimit të aktivitetit mineral. KPMM konsideron se MEA është përgjegjëse për zbatimin e këtij kriteri pasi që ajo edhe i lëshon ato (lejet mjedisore). KPMM në komunikatën për media në dhjetor 2020, raporton se: ‘KPMM-ja aktualisht menaxhon me 699 subjekte minerare nga të cilat 149 janë licenca të hulumtimit; 227 licenca të shfrytëzimit; dhe 323 leje për aktivitete të veçanta’.

Si rezultat i dështimit të funksionimit të institucioneve ndodhin edhe aktivitete të ndryshme ilegale që anashkalojnë aspektin mjedisor. Mos-konsiderata të tilla shkaktojnë degradimin e mjedisit. Numri i operimeve ilegale të evidentuara nga KPMM në vitin 2020 është 59. Mirëpo gjendja është edhe më e rëndë në dritë të vlerësimit të Auditorit Kombëtar se KPMM nuk ka menaxhim të duhur të procesit për parandalimin e operuesve illegal. Për më tepër, ndodhë shpesh që bëhet vazhdimi i licencave të Operatorëve Ekonomik pa u rikultivuar/rehabilituar zonat e eksploatuara siq obligohen OE-të të bëjnë tre muaj para skadimit të licencës dhe lejes.

⁴ ‘Raportii Auditimit të Performancës, Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industrial dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari’, Zyra Kombëtare e Auditimit, dhjetor 2020.

⁵ ‘KPMM, Komunikatë për media (29 dhjetor 2020), Qasur në: <https://kosovo-mining.org/aktivitet/komunikate-per-media-6/>, më 14 mars 2021.

⁶ Ibid

⁷ ‘Raportii Auditimit të Performancës, Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industrial dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari’, Zyra Kombëtare e Auditimit, dhjetor 2020.

Sipas të dhënave të fundit të KPMM-së, shfrytëzimi i mineraleve ndërtimore dhe industriale është sektor i cili ka shënuar rritje të lartë në mbështetjetë zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e vendit. Si rezultat i rritjes së eksploatimit të lartë të mineraleve ndërtimore dhe industriale, Kosova po përballët edhe me degradim të lumenjëve, kodrave dhe zonave malore nga të cilat nxirren materiale ndërtimore dhe industriale. Gurëthyesit raportohen të jenë ndër shkatërruesit e mëdhenj të natyrës.

Për dallim nga disa prej strategjive pjesë e kësaj analize, në pjesën narrative SMRK i mungojnë detaje lidhur me afatet kohore, institucionet përgjegjëse, kostja e përgjithshme e ajo për realizimin e masave, si dhe burimi financiar. Disa nga këto detaje janë për këtë sektor jipen në Planin Veprimit. Kjo reflekton standardin e ndryshëm të Strategjive të punuara asokohe, para se Zyra e Kryeminitrit të rekomandojë një standard të unisuar për dokumentet e tilla.

Raportet e monitorimit që tregojnë për zbatimin e SMRK, nëse ndodhin dhe janë të shkruara, nuk janë dokumente që publikohen në webfaqen e MEA. Pyetjet e dërguara te Skender Sallahu, Drejtor i Departamentit për Miniera në MEA, nuk kanë marrë përgjigje.

Për fund, edhe pse Kosova ka rezerva të konsiderueshme të mineraleve metalore, energjetike, industriale dhe mineraleve ndërtimore, ende nuk ka gjetur mënyrën për valorizimin e tyre dhe përdorimin e tyre të qëndrueshëm - në mënyrë që t'i sjellin vendit zhvillim. Kjo edhe përkundër faktit se tri nga katër parimet e SMRK adresojnë pikërisht këtë pikë. Në anën tjetër, edhe pse kjo Strategji është shkruar me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe minimizimit të efekteve negative në të, në praktikë, Kosova

⁸ EC Ma Ndryshe, 'Gurthyesit – Shkatërrues të Ambientit dhe Shëndetit Publik', Qasur në: <https://ecmandryshe.org/?page=1,17,734#.YE21Yi1h3s0>, më 14 mars 2021.

⁹ Tani institucionet përgjegjëse janë duke u realizuar monitorimin e implementimit të planit të veprimit të kaluar (2018 – 2020), dhe pastaj do të hartohet planit të ri (2021 – 2023).

¹⁰ Pyetjet janë adresuar te Skender Sallahi, Drejtor i Departamentit të Minierave më 24 shkurt 2021 dhe 12 mars 2021.

STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E PYLLTARISË 2010 – 2020

Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë për periudhën 2010–2020 (SZHP), është hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). SZHP është dokument 36 faqësh që përbëhet nga Hyrja dhe 4 kapituj kryesor: 1. Roli i Qeverisë, 2. Gjendja e sektorit pyjor, 3. Politikat për intervenim në fushat me prioritet, dhe 4. Korniza për implementimin e strategjisë. SZHP renditë pyjet si pjesë e pasurisë kombëtare/trashëgimore. Sipas saj, pyjet duhet të menaxhohen në atë mënyrë që të ofrojnë prodhimtari të qëndrueshme, dhe në të njëjtën kohë të ruajnë larminë biologjike për të mirën e gjeneratave të tashme dhe atyre të ardhshme. Pyjet në Kosovë mbulojnë 47% të territorit të Kosovës.¹¹ 62% e pyjeve janë në pronësi publike, ndërsa 38% janë në pronësi private.

Objekti i përgjithshëm i SZHP-së, është ‘që të ngritet kontributi i sektorit pyjor në ekonominë nacionale, nëpërmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve pyjore, duke marrë parasysh gjithmonë rolin shumëfunksional të pyjeve.’ Një ndër pohimet e njohura që në fillimet e hartimit të kësaj Strategjie është edhe njohja se gjendja e resurseve pyjore është e pakënaqshme. Në fakt, ajo karakterizohet me shfrytëzim të paqëndrueshëm; me intensitet të ulët në menaxhimin e pyjeve; me mbrojtje të pamjaftueshme; dhe shfrytëzim nën optimal të resurseve pyjore. Mbrojtja e vlerave mjedisore theksohet të jetë një ndër përgjegjësitë e Qeverisë në zhvillimin e sektorit pyjor në përputhje me Konferencën e Kombeve të Bashkuara në Rio de Zhanjero 1992, dhe strategjitë e BE-së.

kërcënimeve të ekosistemeve pyjore. Tani Kosova ka rreth 120.000 ha sipërfaqe të zonave të mbrojtura apo 12% të pjesëmarrjes së zonave të mbrojtura në totalin e sipërfaqes së Kosovës.

¹¹ ‘Raport i treguesve mjedisorë - Mjedisi i Kosovës 2020’, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

SZHP identifikon 8 fusha të cilat kanë ndikim në sektorin pyjor, dhe analizon aspektin politik dhe strategjik të masave. Masa e pestë, parashah, mbrojtjen mjedisore pyjore. Sipas Udhëheqësit të Divizionit të pylltarisë në MBPZHR, Kemajl Kadriu, në kuadër të kësaj mase është realizuar zgjerimi i sipërfaqes së parkut Kombëtar ‘Sharri’ dhe shpallja e ‘Bjeshkëve të Nemuna’ Park Kombëtar.¹² Duke rritur hapësirën e zonave të mbrojtura është tentuar të ndikohet në ruajtjen e biodiversitetit, dhe parandalimin e kërcënimeve të ekosistemeve pyjore. Tani Kosova ka rreth 120.000 ha sipërfaqe të zonave të mbrojtura apo 12% të pjesëmarrjes së zonave të mbrojtura në totalin e sipërfaqes së Kosovës.¹³

Në analizën e gjendjes, SZHP identifikon sipërfaqen e tokave pyjore (publike dhe private), llojet dominuese të specieve (ahu, bungu, breu, harmoqi dhe pisha), si dhe analizon vështirësitë e sektorit pyjor. Një ndër vështirësitë kryesore theksohet të jetë respektimi i ligjit, tregu i drurit, moszhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të pyjeve, pyjet e pambrojtura, etj.

Korniza për zbatimin e strategjisë bazohet në 3 shtylla:

- I. Projekte të hartuara për ngritjen e njohurive në fushat e pazhvilluara,
- II. Mbështetje për përmirësim të operacioneve dhe ndryshim të veprimeve,
- III. Mbështetje për institucionet e Qeverisë që kanë përgjegjësi të plotë për zbatimin e strategjisë.

Institucionet kryesore për sektorin e pylltarisë janë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Agjencia Pyjore e Kosovës (APK). MBPZHR është autoriteti më i lartë përgjegjës për pylltari në Kosovë. Departamenti i saj i Pylltarisë harton politikat dhe kornizën rregullative, si dhe bënë inspektimin e operacioneve pyjore. APK është agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të MBPZHR. APK i ka shtatë drejtori qendrore që merren drejtëpërdrejtë me menaxhim, hulumtime, inspektime etj; dhe gjashtë drejtori koordinuese rajonale që koordinojnë aktivitetet

¹² Komunikim me Kemajl Kadriu, Udhëheqës i divizionit, Departamenti i pylltarisë, MBPZHR.

¹³ ‘Raporti i treguesve mjedisor - Mjedisi i Kosovës 2020’, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

pyjore përmes 29 njësive komunale. Një prej detyrave kryesore të këtyre njësive është bashkëpunimi me qeveritë lokale (komunat).

Menaxhimi i pyjeve kërkon qasje që bazohet në respektimin e parimeve ekologjike, gjë e cila rezulton të jetë e pa zbatueshme në Kosovë me vite të tëra. Kjo edhe përkundër faktit se rreth “90% e sipërfaqeve pyjore tani kanë plane të reja menaxhimi” .¹⁴ Menaxhimi i pyjeve në harmoni me ekologjinë ishte identifikuar si problem edhe në kohën e hartimit të strategjisë ekzistuese 2010-2020, 10 vite më parë. Andaj, në mënyrë që të përmirësohet gjendja, nevojitet që institucionet përgjegjëse të ndërmerrin hapa më rigoroz për zbatimin e ligjeve dhe strategjive në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Fakti se druri është një ndër burimet kryesore të energjisë për ngrohje bënë që kërkesa për dru të jetë shumë më e lartë se oferta. Një gjë e tillë ka ndikuar që pyjet të shndërrohen në shënjestër të veprimtarive joligjore, sidomos në pjesën veriore të Kosovës. Sipas të dhënave nga regjistrimi i pyjeve (2012-2013), 93% e prerjeve të pyjeve nuk bëhet në pajtim me dispozitat ligjore, nga të cilat 59% në pyjet publike, ndërsa 34% në ato private.¹⁵ Pasojat kryesore e të drejtëpërdrejta të veprimeve të tilla shkaktojnë degradim të tokës pyjore, erozion, zvogëlim të emetimit të oksigjenit, shkatërrim të biodiversitetit, rritje të rrezikut nga përmbytjet dhe zjarret pyjore. Marrë parasysh gjitha këto, institucionet kanë dështuar të përmbushin cakun e SZHP-së për zvogëlimin e prerjeve ilegale dhe të parregullta.

Zjarret pyjore janë problem i dyfishtë sepse ato ndikojnë jo vetëm në dëmtimin e pyjeve dhe biodiversitetit, por edhe në rritjen e emisioneve të gazrave serrë nga ky sektor. Krahas dëmtimit të vitalitetit të pyjeve, zjarret shkaktojnë edhe sëmundje të pyjeve edhe humbje ekonomike. Sipas të dhënave nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës,

¹⁴ Komunikim me Kemajl Kadriu, Udhëheqës i divizionit, Departamenti i pylltarisë, MBPZHR.

¹⁵ ‘Raporti i treguesve mjedisor - Mjedi i Kosovës 2020’, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

gjatë periudhës 2008–2018 rreth 14.144 ha sipërfaqe e pyjeve private dhe publike janë djegur. Numri më i madh i sipërfaqeve të djegura të pyjeve ka ndodhur në vitin 2012 me 5.604 ha. Fatmirësisht, trendi i përgjithshëm i zjarreve në pyje është në rënie. Të dhënat e fundit për këtë temë i përkasin vitit 2018, në të cilin janë regjistruar 949 ha pyje të djegura.¹⁶

Zhvillime pozitive, të listuara nga zyrtarët e MBPZHR-së¹⁷ për zbatimin e kësaj strategjie janë: Hartimi i Strategjisë për prodhime të dyta pyjore 2014-2020; Programi kombëtar për pyllëzimin dhe ripyllëzimin e pyjeve dhe tokave pyjore 2018-2027; Programin kombëtar për shëndetin pyjor 2018-2027; Kompletimi dhe modernizimi i laboratorit për analiza entomologjike dhe fitopatologjike në Institutin e Pyjeve në Pejë; Hartimi i Strategjinë për komunikim dhe informim 2013-2020; Dizajnimi dhe zhvillimi i sistemit informativ për pyjet e Kosovës (SIPK); Programi për trajtimin e pyjeve të reja dhe bashkëpunimi me MPMS në aspektin punësimit; Hartimi i Planeve të reja të menaxhimit me pyje në rreth 90 % të njësive menaxhuese të pyjeve (e cila u përmend edhe më lart); Identifikimi i 8 grumbujve farorë etj.

Sfidat kryesore në zbatimin e strategjisë janë ligjore (miratimi i ligjit të ri mbi pyjet), politike dhe financiare. SZHP si mekanizëm për zbatimin e strategjisë e parashah krijimin e një Bordi Menaxhues ‘i cili do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për realizimin e të gjitha aktiviteteve që dalin për zbatimin e strategjisë.’ Sikurse edhe bordet tjera, edhe ky bord njihet si bord i përfaqësimit të pushteteve dhe i zgjedhur në shumicën e rasteve në mënyrë joligjore. Formimi i këtij Bordi nuk ka prodhuar rezultat në planifikimin dhe zbatimin e strategjisë, dhe koordinimin e institucioneve/ministrive të ndërlidhura. Mos koordinimi i institucioneve përgjegjëse është problem që trajtohet në shtyllës së 3-të të SZHP-së. Përveç problemeve të lartcekura, edhe kontrollet e dobëta inspektuese, mungesa e burimeve njerëzore dhe ekspertizës, si dhe mosfunktionimi i sistemit të drejtësisë, tash e as vite kanë bërë pylltarinë më joshëse për veprimtari joligjore. Si rezultat, zbatimi i SZHP është i pjesshëm.

¹⁷ Komunikim me Kemajl Kadriu, Udhëheqës i divizionit, Departamenti i pylltarisë, MBPZHR.

Si pikë e parafundit në SZHP, është përmbledhja e aktiviteteve për zbatimin e strategjisë (ku listohen edhe institucionet përgjegjëse). Mirëpo dokumenti nuk i referohet buxhetit të masave, apo burimeve financiar për realizimin e tyre. Gjithashtu, strategjia nuk ka SWOT analizë. Mirëpo, pika e fundit e SZHP parasheh rreziqet që mund ta pengojnë apo pamundësojnë zbatimin e saj.

Afati kohor i kësaj strategjie, tanimë ka skaduar. MBPZHR tani është në proces të vlerësimit të zbatimit të SZHP me qëllim të përcaktimit të përmbushjes së masave dhe sfidave që strategjia kishte gjatë zbatimit të saj. MBPZHR tani ka themeluar ekipin punues për hartimin e strategjisë së re afatgjatë 2021-2030¹⁸ me mbështetje të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (Food and Agriculture Organization - FAO).

Për fund, siç është e njohur dhe pranuar edhe në vet strategji - nisur edhe nga përvojat e gjithë rajonit - sistemet e mbrojtjes që mbështeten vetëm në zbatimin e ligjit si të vetmin mjet për zvogëlimin e aktiviteteve të dëmshme për mjedis, nuk mund të jenë efikase sa duhet. Për këtë arsye rekomandohet që krahas mbrojtjes së pyjeve si prioritet qeveritar, zbatimit të sistemeve të menaxhimit të pyjeve, dhe bashkëpunimit më të mirë institucional, të investohet edhe në ngritjen e vetëdijes së publikut për rëndësinë e pyjeve, dhe benefiteve ekonomike nga shfrytëzimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme. Realizimi i SZHP është vetëm i pjesshëm. Edhe përkundër disa rezultateve që kryesisht kanë të bëjnë me miratimin e dokumenteve, situata në terren len shumë për të dëshiruar. Strategjia e re mund të jetë shumë mirë e realizuar, mirëpo nëse nuk monitorohet dhe zbatohet, atëherë analiza e gjendjes do të jetë po aq negative sa ajo e SZHP-së 10 vite më parë.

¹⁸ Komunikim me Venhar Nushi, Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikave, Zyra për Planifikim Strategjik.

STRATEGJIA E ENERGJISË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2017 – 2026

Sektori i energjisë luan rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në jetën tonë. Por ndikimet e saj në mjedis janë mjaft të theksuara. Çdo mënyrë e prodhimit të energjisë ka ndikim në mjedis. Andaj zgjedhja e llojeve të burimeve të energjisë dhe teknologjive të përshtatshme është e rëndësishme për zvogëlimin të këtij ndikimi.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2017–2026 (SERK), është dokument në të cilin paraqitet traseja zhvillimore e kapaciteteve energjetike në vend. Ky dokument përbëhet nga 6 kapituj dhe 8 anekse. Misioni, vizioni dhe objektivat strategjike të SERK janë paraqitur në Kapitullin 3. Gjendja aktuale e sektorit të energjisë në Kosovë përshkruhet në Kapitullin 4, derisa lista e aktiviteteve dhe masave të përzgjedhura për arritjen e objektivave strategjik janë të paraqitura në Kapitullin 5. Krejt në fund, në Kapitullin 6, është paraqitur një vështrim i përgjithshëm i aktiviteteve kyçe, kostove të përlogaritura dhe hapave të ardhshëm për zbatim e SERK. SERK parasheh koston e aktiviteteve kyçe në të cilën nga €3.06 miliardë, €1 miliard, apo 1/3, e koston së planifikuar i atribuohet projektit ‘Kosova e Re’. Pjesa tjetër alokohet për: Rehabilitimin e TC ‘Kosova B’, Dekomisionimin e TC ‘Kosova A’, Zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të energjisë termike, masave për efikasitet të energjisë (EE) dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE), etj.

Institucionet kompetente për sektorin energjetik janë: Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Agjencioni Kosovar për Efikasitet të Energjisë, Fondi për Efikasitet të Energjisë, Operatorët e transmissioinit dhe distribucionit, Korporata Energjetike e Kosovës, etj.

Në pjesën tekstuale të trupit të SERK janë theksuar objektivat dhe masat e politikave energjetike, kurse sfondi analitik është dhënë në Aneks. Një ndër to është edhe Plani i Veprimit që është lehtë i qasshëm në webfaqen e Zyrës së Kryeministrit. SERK si dokument përmbanë SWOT analizë të përgjithshme të sektorit të energjisë në vend.

Edhe pse në konsideratat primare të SERK është sigurimi dhe zgjerimi i kapaciteteve prodhuese dhe të shkëmbimit të energjisë elektrike, një gjë e tillë parashihet të bëhet krahas përmbushjes së obligimeve për eficiencë të energjisë, arritje të caqeve të burimeve të ripërtritshme dhe ndikimit sa më minimal në mjedis. Andaj, mbrojtja e mjedisit është konsideratë e rëndësishme e shprehur që në misionin e SERK (2017-2026), i cili thotë: “Misioni i Strategjisë së Energjisë është krijimi i kushteve për furnizim të besueshëm dhe të sigurtë me energji, për kërkesën në rritje për energji, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse, duke pasur në konsideratë diversifikimin e burimeve, përdorimin me eficiencë të energjisë, shfrytëzimin maksimal të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe mbrojtjen e mjedisit në të gjitha aktivitetet e sektorit.”

SERK përmbanë pesë objektiva kryesore:

- 1 Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike;
- 2 Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë;
- 3 Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja;
- 4 Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror;
- 5 Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në eficiencë të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.

Në Planin e Veprimit, për objektivën e 5 që trajton mjedisin, EE dhe BRE janë paraparë të realizohen 13 masa apo objektiva specifike dhe 41 aktivitete. Objektivat strategjike gjithashtu kanë të përcaktuar edhe institucionin përgjegjës për të zbatuar masat në fjalë.

Objektiva e pestë njihet detyrimet e Kosovës për zbatimin e direktivave evropiane për mjedisin. Mirëpo, duket se ky zotim përfundon me vet këto fjali, meqë zhvillimet në sektorin e energjisë nuk bëhen në përputhje me parimin e mbrojtjes së mjedisit. Fakti se eficientia e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtja e mjedisit, përfshihen në një objektivë të vetme, tregon për mungesën e seriozitetit dhe prioritizimit të secilës nga këto tri çështje kyçe për vendin. Kjo vërehet edhe nga gjuha e përdorur tek kjo objektivë e cila prezantohet si detyrim i jashtëm, dhe jo orientim i brendshëm i mirë-vlerësuar i cili do të sjellë benefite ekonomike dhe mjedisore për Kosovën.

Kapitulli 4 i Gjendjes aktuale në sektorin e energjisë në Kosovë, flet për problemet e sektorit të energjisë (elektrike, termike dhe të gazit natyror, burimeve të ripërtëritshme, eficientës së energjisë) si dhe për gjendjen mjedisore. Problemet në sektorin mjedisor nga sektori i energjisë më së shumti i atribuohen prodhimit të energjisë nga termocentralet. Kjo vije si rezultat i teknologjisë së vjetëruar që ato kanë dhe resursit minerar (qymyri) që ato përdorin si burim energjie.

Kosova vazhdon të jetë një vend shumë i varur në karburantet fosile, i cili merr 95% të energjisë elektrike nga dy termocentralet me bazë linjitin. Dy termocentralet e Kosovës (Kosova A dhe Kosova B), së bashku përbëjnë burimin më të madh të emitimit të grimcave në Evropë.¹⁹ Gazrat e emituara nga termocentralet përmbajnë sasi të mëdha të dioksidit të sulfurit, oksideve të nitrogjenit dhe të pluhurit,²⁰ për ndikimet e të cilave do të flitet në kapitullin 8 të kësaj analize. Problem për mjedisin paraqesin edhe deponitë e hirit, si dhe gërmadhat e krijuara gjatë mihjes së qymyrit.

Sidoqoftë, problemet mjedisore të cilat janë evidente nga sektori i energjisë nuk rezultojnë vetëm nga termocentralet. Kohëve të fundit, problem madhor mjedisor kanë paraqitur edhe ndërtimet e hidrocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, prerja e pakontrolluar e drunjëve për prodhim të energjisë termike

¹⁹ HEAL (2016), Fatura e papaguar shëndetësore. http://env-health.org/IMG/pdf/factsheet_kosovo_en_lr-2.pdf.

²⁰ Ndikimet në shëndetin publik të grimcave dhe ndotësve të tjerë nga termocentralet shkaktojnë probleme të frymëmarrjes, bronkit dhe astmë, si dhe vdekje të parakohshme.

(e trajtuar në kapitullin 5 të kësaj analize) dhe djegja e substancave të ndryshme fosile të cilat ndikojnë në ndotjen e ajrit.

SERK në përgjithësi është e dominuar nga plani i kahmotshëm për ndërtimin e termocentralit ‘Kosova e Re’. Ky projekt tanimë është i dështuar për shkak të mungesës së fondeve nga kompania e përzgjedhur për investim, Contour Global, dhe distancimi i institucioneve ndërkombëtare financiare nga mbështetja e projekteve me bazë qymyrin/linjtin. Ky projekt për një kohë të gjatë është pare si aktivitet kryesor në sektorin e energjisë. Gjykuar nga ky fakt, lehtë mund të përfundohet se SERK nuk dëshmon orientim të Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit nga sektori energjetik. Për më tepër, këtij dokumenti i mungon çfarëdo integrimi i politikave të sektorit të mjedisit. Kostoja mjedisore dhe shëndetësore në koston e përgjithshme të prodhimit të energjisë elektrike me bazë linjtin është një element i cili neglizhohet tërësisht

Raporti i Progresit për vitin 2019, i Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020²¹, tregon për disa të arritura në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Një ndryshim pozitiv, edhe pse reduktimi i ndikimit në mjedis vlerësohet si minimal, është kalimi i Ngrohtores ‘Termokos’ nga djegja e mazutit (si lëndë djegëse e rëndë me cilësi të ulët) në projektin e koogjenerimit në TC ‘Kosova B’. Gjithashtu, efekt pozitiv në mjedis krahasuar me gjendjen e mëparshme ka nga zgjerimi i rrjetit të Ngrohtores ‘Termokos’ tek konsumatorë të rinjë, të cilët bëjnë kalimin nga përdorimi i burimeve tjera të energjisë në energji më eficiente. Përmirësimet tjera janë: remonti i blloqeve të termocentraleve (A3 e TC Kosova A dhe B2 e TC Kosova B); investimet në masat e EE në objektet publike të nivelit qëndror dhe komunal²²; dhe rrija e pjesëmarrjes së BRE-ve në bruto konsumin final të energjisë në vend²³.

²¹ Raporti i Progresit për vitin 2019 i Programit të zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Qershor 2020.

²² Projekte të kredituara institucionet financiare dhe programet e vecanta: Banka Botërore, KfW, WBIF.

²³ Energjia e ripërtëritshme merr pjesë me rreth 20% të konsumit total të energjisë, dhe rreth 6% të prodhimit total të energjisë elektrike.

Mirëpo, një e metë e SERK është mospërfshirja e naftës si burim energjie. Pjesëmarrja e naftës si burim energjie në konsumin final ka përqindje të lartë (46%) . Për më tepër, nafta është burim energjie i cili ka shënuar rritje në konsum në vazhdimësi. Duke pasë parasysh ndikimin që ka nafta, e sidomos nafta e cilësisë së dobët, në mjedis, është e rëndësishme që kjo substancë të përfshihet në SERK dhe të planifikohet zëvendësimi me burime tjera më të pastra të energjisë.

Strategjia ekzistuese e Energjisë 2017–2026 është duke u rishikuar për arsye të caqeve të reja për EE dhe BRE nga Komuniteti i Energjisë, dhe realitetit të ri të krijuar pas dështimit të TC ‘Kosova e Re’. Në mënyrë që të minimizohet ndikimi i sektorit të energjisë në mjedis, Kosova duhet të i diversifikojë burimet e saja të energjisë, investojë në eficiencën e energjisë, liberalizojë tregun e energjisë, dhe të integrohet me tregun rajonal të energjisë.

Për fund, edhe pse furnizimi me energji të besueshme dhe konstante, dhe zgjerimi i kapaciteteve të reja gjeneruese në harmoni me mjedisin janë prioritet deklarativ i SERK, në praktikë konsiderata për mjedis është tejet e minimale. Andaj rishikimi i kësaj strategjije është nevojë e kohës. Ky rishikim detyrimisht se duhet të reflektojë mbi pamundësinë e ndërtimit të termocentralit të ri me bazë linjtin; duhet t’a përfshijë realitetin e ri lidhur me caqet obligative për EE dhe BRE; si dhe zhvillimet në raport me integrimin e tregut energjetik të Kosovës me atë Evropian dhe rajonal, sidomos me Shqipërinë. Për më tepër, Strategjia e re energjetike duhet të reflektojë mbi mangësitë e tanishme, pengesat e hasura dhe abuzimet mjedisore të cilat janë bërë përgjate viteve në emër të gjenerimit të energjisë. Indikator kryesor që ndikimi në mjedis i sektorit të energjisë merret seriozisht nga institucionet e Kosovës do të jetë alokimi i buxhetit të Kosovës për EE dhe BRE, dhe jo mbështetja gati si e tërësishme në asistencë zhvillimore për çdo gjë që cilësohet si energji e gjelbërt.

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019), Balanca vjetore e Energjisë në Republikën e Kosovës për vitin 2019.

STRATEGJIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2013 – 2022

Rritja e numrit të popullsisë në botë dhe industrializimi i shpejtë janë duke ndikuar në mjedis, shëndet publik dhe ekonomi. Jeta dinamike dhe konsumimi i produkteve të ambalazuara janë duke kontribuar në gjenerimin e lartë të mbeturinave të cilat nuk mund të trajtohen e asgjësohen, dhe të cilat përfundojnë në natyrë duke shkaktuar ndotje mjedisore.

Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave për periudhën 2013-2022 (SRKMM), synon ndarjen e kompetencave, përcaktimin e objektivave kryesore, masave dhe projekteve të cilat Kosova duhet t'i realizojë për një periudhë 10 vjeçare. Objektive kryesore e kësaj Strategjie është krijimi i një kornize masash për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që aktualisht krijohen, dhe do të ndikoj në ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave.

Pjesa dërmuese e SRKMM është shpjegim i gjendjes dhe llojeve të mbeturinave në vend. Mbeturinat klasifikohen sipas katalogut shtetëror për mbeturina në bazë të veçorive që kanë në: mbetrina të parrezikshme dhe mbeturina të rrezikshme dhe inerte. Ndërsa në bazë të vend-burimit ato ndahen në: mbeturina komunale, industriale, të veçanta dhe medicinale.

SRKMM, e publikuar në webfaqen e Kryeministrit është dokument i cili ende ka shenja të verzionit 'draft' në faqet e para të saj, dhe është dokument i vështirë për tu naviguar. Kapitulli 3 i saj trajton për masat dhe objektivat. Nën-kapitujt e saj përfshijnë:

- 3.1. Masat për realizimin e objektivave të strategjisë,
 - 3.2. Objektivat dhe afatet kohorë për administrim të mbeturinave, dhe
 - 3.3. Masat për realizimin e objektivave (të përgjithshme dhe të veçanta).
- 3.1. dhe 3.3 krijojnë konfuzitet, ngase përmbajnë veprimeve të ngjajshme.

Kapitulli 4 i kësaj strategjie, trajton opsionet e ndryshme të menaxhimit të mbeturinave: 1. Parandalimin, 2. Ripërdorimin dhe reciklimin, 3. Trajtimin termik, dhe 4. Deponimin përfundimtar. Aty vlerësohen edhe përparësitë dhe mangësitë e të gjitha opsioneve, por jo edhe mundësitë dhe rreziqet, siç praktikohet me SWOT analizë.

Objektivat e strategjisë janë të paraqitura në faqen e saj të fundit. Ato përmbajnë:

Objekti 1: Masat e përgjithshme për forcimin e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave;

Objekti 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturën për mbeturina;

Objekti 3: Rritja e shkallës së vetëdijsimit, ndërgjegjësimit dhe informimit.

Për dallim nga disa strategji tjera, SRKMM parasheh edhe vlerësimin e investimeve dhe burimeve të mjeteve financiare. Ajo parasheh që jo më shumë se gjysma e fondeve të përgjithshme të sigurohet nga të ardhurat publike, ndërsa pjesa tjetër nga burime tjera. Investimi total i nevojshëm për zbatimin e SRKMM llogaritet të jetë €133.85 milion.

Strategjia ka planifikuar 12 veprime/masa²⁵ të ndara në dy periudha kohore. Faza e parë, përfshinë periudhën nga viti 2013-2017 dhe parasheh ndërtimin dhe stabilizimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave përmes zbatimit të 33 projekteve të planifikuara. Faza e dytë, përfshinë periudhën nga viti 2018-2022, dhe parasheh zhvillimin e sistemit të ndërtuar për arritjen e synimeve.

²⁵ 1. Trajtimi i mbeturinave nga konstruktiv demolimi, 2. Zgjerimi i deponive sanitare, 3. Trajtimi i mbeturinave të biodegradueshme, 4. Përmirësimi i gjendjes së deponive komunale të mbeturinave, 5. Furnizimi me makineri dhe pajisje për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale, 6. Eliminimi i deponive ilegale, 7. Ndërtimi i qendrës për trajtimin e mbeturinave, 8. Rrjeta e qendrave për grumbullimin dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje, 9. Zvogëlimi i krijimit të mbeturinave, 10. Masat e përgjithshme, 11. Menaxhimi i mbeturinave të rreikshme dhe 12. Rehabilitimi i vendeve të ndotura me mbeturina industriale dhe të minierave.

Mirëpo, raporti i monitorimit të realizimit të planit për menaxhimin e mbeturinave i bërë në vitin 2018, tregon se vetëm 27.28% e projekteve ishin realizuar, 30.31% ishin në realizim e sipër, ndërsa 42.43% nuk kishin filluar fare.²⁶ Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve financiare, ngase Qeveria e Kosovës nuk e ka mjedisin prioritet e rrejdhimisht as menaxhimin e mbeturinave si sektor.²⁷

Nga total €133.85 milion të investimit të nevojshëm për aktivitetet e parapara në strategji, nga vlerësimi i SRKMM në vitin 2018, raportohet se janë realizuar vetëm €9.22 milion, dhe në realizim e sipër ishin €17.5 milion. Kjo tregon për një intenzitet të ulët të zbatimit të masave. Edhe pse në hyrje të SRKMM, vlerëson se gjendja e menaxhimit të mbeturinave ‘është mjaft e palakmueshme’ dhe se ‘ndotja e mjedisit nga menaxhimi jo i drejtë i mbeturinave është ndër problemet më të mëdha në kuadër të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë’ ky rezulton të mos jetë alarm i mjaftueshëm për Qeverinë (e një pas njëshme) për të alokuar mjete në mënyrë që të zbatoheshin veprimet e parapara me strategji. Projektet e realizuara në 5 vitet e para të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave raportohet se kryesisht janë financuar nga donatorët.²⁸ Mirëpo, edhe tani, tetë vite pas hartimit të kësaj strategjie, gjendja në teren nuk është përmirësuar. Andaj edhe vlerësimi për zbatimin e kësaj strategjie është: i pjesshëm.²⁹

Strukturat pjesëmarrëse për menaxhimin e mbeturinave janë: Kuvendi i Kosovës, Qeveria, komunat, kompanitë rajonale publike, operatorët privat, bizneset si dhe pjesëmarrës tjerë.

Bazuar në vet tekstin e SRKMM, keqmenaxhimi i këtij sektori ka shkaktuar pasoja të rënda në ajër, tokë, ujë, dhe shëndet publik. Të dhënat tregojnë se mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave janë duke u rritur nga viti në vit, nga

²⁶ Komunikim me Enver Tahiri. Udhëheqës i Divizionit për mbeturina dhe kimikate, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, MEA.

²⁷ Ibid


²⁸ Ibid

²⁹ ‘Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2017’, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

³⁰ ‘Raport mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, 2018’, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

nga 57,7% në vitin 2016, në 70.9% në vitin 2017, dhe 75.6% në vitin 2018. Sidoqoftë, në mënyrë që të adresohet plotësisht objektiva për rritjen e kapacitetit të grumbullimit të mbeturinave dhe të përmirësohet sistemi aktual i grumbullimit të mbeturinave nevojitet ende punë.

Hedhja ilegale e mbeturinave dhe rrjedhimisht ndotja e mjedisit mbetet sfida. Nga viti në vit shënohet rritje e deponive ilegale, përkundër aksioneve të pastrimit të vazhdueshme. Nga 1,572 deponi ilegale në vitin 2017, në vitin 2018 u shtuan edhe 957 të tjera të cilat bënë që numri i deponive ilegale të arrijë gjithsej në 2,529. Problemi i deponive ilegale është shumë dimensional, i cili vije si pasojë e mosmbulimit me shërbim të gjithë territorit të vendit, vetëdijes së ulët të qyteatrëve dhe mungesës së penalizimeve për ndotësit.



Grafi 1. Deponitë ilegale sipas llojit të mbeturinave (2019)³¹

³¹ 'Raport mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë, 2018', Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Raporti për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë (2017), vlerëson gjendjen e deponive sanitare në Kosovë si jo të kënaqshme. Kjo gjendje është si pasojë e shumë faktorëve, por me theks të veçantë nga menaxhimi jo i mirë i deponive. Shqetësues mbete fakti se sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare është në rritje.

Trajtimi i mbeturinave duhet pare si mundësi biznesi. Metali, plastika dhe letra janë materialet me përqindjen më të lartë të trajtimit dhe përpunimit nga ana e kompanive. Në vitin 2016 (kur edhe ekzistojnë të dhënat e fundit zyrtare), sasia e mbeturinave të trajtuara ka qenë 62,461 ton.^{32 33}

Mbeturinat tjera që shkaktojnë dëme mjedisore janë edhe mbeturinat medicinale dhe ato industriale nga: a) xehtaria dhe duroret, b) prodhimi, c) furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, d) furnizimi me ujë, kanalizime, menaxhimi i mbeturinave dhe revitalizimi i tokës, e) ndërtimtaria dhe f) sektorët e shërbimeve, të cilat paraqesin ndikime të mëdha mjedisore gjithashtu.

Andaj, për të ndryshuar gjendjen duhet adresuar objektiva për edukim të publikut përmes programeve të dizajnuara për target grupe të ndryshme. Mirëpo, përveç programeve të edukimit të publikut, është e nevojshme që të ofrohen edhe trajnime për personelin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Shumë nga iniciativat e kësaj natyre deri më tani kanë qenë vetëm nga projektet e palëve të treta (OJQ dhe donatorë).

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmet që i shkaktojnë mbeturinat kërkon zbatimin e legjislacionit të miratuar në fushën e mbeturinave. Deri me 2017 janë hartuar 32 akte nenligjore për mbeturina ku janë caktuar standardet, teknikat dhe metodat për trajtimin e tyre të cilat ndikojnë në zvogëlimin e vëllimit të mbeturinave dhe efekteve negative në mjedis.

³² Ndërsa sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare në vitin e njëjtë ishte: 372,602.33 ton.

³³ 'Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2017', Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

³⁴ Komunikim me Enver Tahiri, Udhëheqës i Divizionit për mbeturina dhe kimikate në MEA.

STRATEGJIA E CILËSISË SË AJRIT 2013 – 2022

Ajri përmban emetime të liruara nga shumë sektorë: transporti, industria, energjia, dhe amvisëria. Është e dëshmuar tashmë se ndotja e ajrit në nivelet aktuale është shkaktare e një numri të konsiderueshëm të vdekjeve çdo vit. Madje, cilësia e dobët e ajrit ndikon direkt edhe në numrin e lartë të pranimeve në spital, veçanërisht të atyre me sëmundje kardio-respiratore, të cilët janë kategori e ndjeshme edhe për COVID-19. Ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit është kryesisht përtej kontrollit të individëve. Si i tillë, ai kërkon veprim nga autoritetet publike në nivel kombëtar, rajonal dhe madje edhe ndërkombëtar, ngase ndotja nuk është problem që ndalet në kufi.

Strategjia për Cilësinë e Ajrit për periudhën 2013-2022 (SCA), e hartuar nga ish-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapërinor, në vitin 2013, ka vizion ‘arritjen dhe ruajtjen e cilësisë së ajrit, e cila kontribuon në ngritjen e mirëqenies së popullatës dhe mbron shëndetin e tyre dhe të mjedisit’.

Një pjesë e madhe e SCA i kushtohet vlerësimit të ndotjes, si dhe substancave të ndryshme dhe masave të tyre - materieve grimcore (PM_{2.5} dhe PM₁₀), dioksidit të sulfurit (SO₂), diksidit të azotit (NO₂), benzenit, ozonit (O₃), monoksidit të karbonit (CO) – dhe ndikimin e tyre në mjedis.

Sipas SCA, kontribuesit më të mëdhenjë të ndotjes së ajrit në Kosovë, janë: burimet e palëvizshme dhe ato të lëvizshme; burimet në zonat urbane; zonat kryesore të prodhimit të energjisë dhe zonat industriale. Këtu bëjnë pjesë objektet për prodhimin e energjisë, objektet industriale (metalurgjia, mihjet, fabrika e çimentos, etj), sektori i transportit, aktivitetet bujqësore dhe lokacionet ku hedhen mbeturinat.³⁵ Por, në këtë listë mungojnë impiantet me djegie të vogël. Një gjë e tillë tregon mungesë të konsistencës në identifikimin e gjithë ndotësve të mëdhenj, ngase sektori rezidencial në vend paraqet barrë të madhe për cilësinë e ajrit, sidomos në kohën e dimrit. Te sektori i impianteve me djegie të vogël, SCA e konsideron amvisërinë vetëm si një ndër ndotësit, në mes të ndotësve tjerë.

³⁵ Strategjia e Cilësisë së Ajrit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Përkundër mos përfshirjes së impianteve me djegie të vogël në listën e ndotësve të mëdhenj, te pjesa ku përshkruhen masat e SCA, 9 masa i atribuohen pikërisht impianteve me djegie të vogël, 5 sektorit energjetik, 1 masë është për ndotësit industrial, dhe 18 masa për ndotësit e sektorit të transportit.

Jokonsistencë tjetër në SCA shpërfaqet sidomos në dy fjali që shprehen ndryshe për të njejtën gjë. Njëra fjali thotë: ‘mesatarja e konsumit të drurit për nevoja të amvisërisë është 9.7m³ në vit për një amvisëri’ ndërsa fjalia tjetër thotë: ‘sipas të dhënave deri në vitin 2007 vlerësohet se për nevoja të amvisërisë është konsumuar 2.41m³ dru në vit për një amvisëri’. Një gjë e tillë len përshtypjen se SCA nuk ka një analizë të mirëfilltë të gjendjes, apo se ajo qalon në kuptimin

e të dhënave bazike, si parakusht për zgjidhje të problemeve dhe hartim të politikave të duhura për arritjen e objektivave.

Burimet e përveçme të ndotjes së ajrit në SCA listohen të jenë: Termocentralet (Kosova A dhe Kosova B); mihjet sipërfaqësore të linjitit; kompleksi industrial në Mitrovicë; Feronikeli në Drenas; fabrika e çimentos Sharrcem në Han të Elezit; sistemet për ngrohje (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë); industria e rëndë bazike (aktualisht nuk funksionon) në Gjakovë, Pejë dhe Gjilan; prodhimi i bazës së asfaltit; transporti, bujqësia etj.

SCA ka 4 objektiva (fillimisht ishin 5 objektiva, me përfshirjen e objektivës për uljen e emisioneve të gazrave serrë³⁶):

1. Zbatimi i legjislacionit për ajrin,
2. Ulja e emisioneve nga burimet e veçanta,
3. Ulja e emisioneve nga burimet mobile,
4. Ulja e emisioneve nga aktivitetet publike.

³⁶ Përshkak të zhvillimeve të reja dhe obligimeve ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe BE për ndryshimet klimatike, Kosova ka draftuar Strategjinë për Ndryshimet Klimatike. Andaj ky objektiv strategjik tani është subjekt zbatimi i Strategjisë për Ndryshime Klimatike.

Edhe pse ka vite që është miratuar kjo strategji, ajo nuk u zbatua në mungesë të Planit Afatgjatë të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (PVCA). Në vend të saj, MMPH miratoi një plan afatshkurtër të urgjencës, si rezultati ditëve me ndotje të madhe në dimrin e vitit 2016-2017. Edhe një plan tjetër i ngjajshëm urgjent u miratua një vit më vonë duke përfshirë 9 nga 12 masat e pa-zbatuara të planit të parë. Një plan veprimi tre-vjeçar 2018-2020 u hartua në fund të vitit 2017, i cili propozon masa sektoriale dhe aktivitete për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

Në kuadër të objektivës së parë për zbatimin e legjislacionit për ajër, MEA me ndihmën e donatorëve është duke: përgaditur inventarin e ajrit; vlerësuar cilësinë e ajrit dhe parashikimet e ndotjes përmes modelimeve; zhvilluar sistemin për matjen e emisioneve në industri³⁷; analizuar gjendjen e stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe riparimin e tyre³⁸. Gjithë këto veprime janë duke u realizuar me ndihmën e ekspertëve të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA).

Duhet theksuar se në letër/ligje, standardet e Kosovës për ajrin janë të njëjta me ato të Bashkimit Evropian (shih tabelën më poshtë). Por, shkalla e zbatimit të këtyre ligjeve dallon në mënyrë të konsiderueshme meqë Kosova është duke çaluar dhe mbetet mbrapa në zbatimin e legjislacionit të saj.

³⁷ Janë bërë matjet e SO₂, NO_x dhe Pluhurit në TC Kosova A dhe TC Kosova B.

³⁸ Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) bënë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përmes Rrjetit Nacional për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit. Rrjeti Nacional i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit është i përbërë nga 12 stacione automatike fikse dhe një stacion automatik mobil.

		Cilësinë e ajrit të ambientit		
PM 10	Mesatarja vjetore 24 orë 24 orë (pragu i informimit) 24 orë (pragu i vigjilimit)	40 µg/m ³ 50 µg/m ³ 100 µg/m ³ 100 µg/m ³	40 µg/m ³ 50 µg/m ³ na na	250 µg/m ³ 50 µg/m ³ na na
PM 2.5	Mesatarja vjetore 24 orë	25 µg/m ³ na	25 µg/m ³ na	10 µg/m ³ 25 µg/m ³
O ₃	Mesatarja maksimale ditore 8 orë 1 orë (pragu i informimit) 1 orë (pragu i vigjilimit)	120 µg/m ³ (objektivi afatgjatë) 180 µg/m ³ 240 µg/m ³	120 µg/m ³ na na	100 µg/m ³ na na
NO ₂	Mesatarja vjetore 1 orë Pragu i vigjilimit	40 µg/m ³ 200 µg/m ³ 400 µg/m ³	40 µg/m ³ 200 µg/m ³ na	40 µg/m ³ 200 µg/m ³ na
SO ₂	24 orë 1 orë Pragu i vigjilimit 10 minuta	125 µg/m ³ 350 µg/m ³ 500 µg/m ³ na	125 µg/m ³ 350 µg/m ³ na na	20 µg/m ³ 500 µg/m ³ na 500 µg/m ³
CO	Mesatarja maksimale ditore 8 orë Mesatarja maksimale ditore 1 orë	10 µg/m ³ na	10 µg/m ³ na	10 µg/m ³ 30 µg/m ³
Plumb	Mesatarja vjetore	0,5 µg/m ³	0,5 µg/m ³	0,5 µg/m ³
Benzen	Mesatarja vjetore	5 µg/m ³	5 µg/m ³	na

Tabela 2: Standardet e Kosovës, BE-së dhe OBSH-së për cilësinë e ajrit.³⁹

³⁹ Banka Botërore, 'Menaxhimi i Ndotjes së Ajrit në Kosovë', tetor 2019.

Ulja e emisionëve nga burimet e veçanta (objektiva e dytë) mbetet sfida kryesore në zbatimin e strategjisë. Pa përmirësimin e teknologjive të sektorit të energjisë dhe zëvendësimin e karburanteve të lëndëve djegëse me burime më të pastra, gjendja e cilësisë së ajrit do të mbetet po e njëjta dhe do të vazhdohet të ketë tejkalime të vlerave të lejuara. Asnjëri nga termocentralet në vend, nuk kanë asnjë teknologji për kontrollin mjedisor të emetimit të NOx ose të dioksidit të sulfurit.⁴⁰ Termocentrali Kosova A ka të instaluar vetëm teknologji për kontrollin e pluhurit, mirëpo, ato tejkalojnë vlerat kufitare të emetimeve të BE-së.⁴¹ Ndërsa, TC Kosova B do të pajiset me filterë për kontrollin e pluhurit, nga mbështetja financiare e BE-së në Kosovë (€76 milionë).

Edhe pse ka një lëvizje në adresimin e masave të SCA, sipas Raportit për Gjendjen e Ajrit 2019, presionet në mjedis nga faktorët e ndryshëm ndotës kanë ndikuar që në periudha të ndryshme kohore, gjatë vitit 2019, Kosova të ketë përkeqësim të cilësisë së ajrit. Ndotja e ajrit është vlerësuar më e lartë në vendet urbane, si: Prishtina, Obiliqi, Drenasi, Hani i Elezit, Mitrovica, etj.⁴² Kjo kryesisht për shkak të koncentrimit të termocentraleve, minierave, fabrikave metalurgjike dhe çimentos në këto vende. Për sektorin e transportit, strategjia dështon të tregojë ndonjë matës specifik për ndotjen, përveç numrit të veturave të regjistruara përgjatë viteve.

Ulja e emisionëve nga burimet mobile (objektivi i tretë), mbështetet kryesisht në Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Prishtinës. Ky plan parasheh të zvogëlojë ndikimin nga burimet mobile ngase parashihet shtimi i shtigjeve për biçikleta, përmirësimi i shërbimeve të transportit publik, dhe largimi i autobusëve të vjetër nga qarkullimi, qasje e kufizuar në zonat e ndotura urbane me automjete me ndotje të lartë, tatimi i automjeteve bazuar në emisione, etj. Mirëpo, Kosovova nuk është vetëm Prishtinë, dhe këto projekte janë ende në fillim për të ditur nëse prodhojnë rezultat të dëshiruar. Në mënyrë që ndikimi i sektorit të transportit të zvogëlohet dhe kontrollohet duhet të investohet më shumë në infrastrukturën e transportit të qëndrueshëm, të sigurohet cilësia e naftës, taksohen automjetet e vjetra etj.

⁴⁰ Banka Botërore, 'Menaxhimi i Ngotjes së Ajrit në Kosovë', tetor 2019.

⁴¹ Ibid.

⁴² 'Raporti vjetor për gjendjen e ajrit 2019'; Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës,

Sipas raportit të Bankës Botërore ‘Menaxhimi i Ndotjes së Ajrit në Kosovë’ përllogaritet se çdo vit në Kosovë vdesin para kohe rreth 760 njerëz, për shkak të ekspozimit ndaj ndotjes së ajrit dhe mjedisit. Kostoja ekonomike e lidhur me dëmin shëndetësor nga ndotja e ajrit ishte ekuivalent me 3.6% të GDP-së për vitin 2016.

Përveç ndikimeve shëndetësore të lart-cekura te popullata që kanë substancat e liruara në ajër, ajri i ndotur ka edhe ndikime mjedisore të drejtpërdrejta në vegjetacion dhe faunë. Ndikimet më të dukshme janë: eutrofizimi i ujërave të ëmbla, shiu acidik, dhe ngrohja globale.

‘Eutrofizimi (mbingarkesa e ekosistemeve ujore me lëndë ushqyese që çojnë në lulëzimin e algave dhe ngjarje anoksike) është një gjendje e vazhdueshme e ujërave sipërfaqësorë dhe një problem i përhapur mjedisor.⁴⁴ Eutrofizimi çon në ndryshime në diversitet të specieve, si rritja e dendur e bimëve ujore që ushqehen me peshq dhe rritja e kafshëve detare. Këto ndryshime ndikojnë edhe në bimët tjera, pastaj.’

‘Oksidet e azotit dhe oksidet e sulfurit nga djegia e lëndëve djegëse fosile kur kombinohen me ujin në atmosferë dhe bien përsëri në tokë, shkaktojnë acidifikimin e tokës dhe shiu acidik. Ky cikël i bën tokën dhe trupat ujorë të papërdorshëm dhe shkakton humbje biodiversiteti’.

‘Ngrohja globale i referohet rritjes së temperaturës në planetin Tokë në një periudhë të caktuar si rezultat i emitimit të CO₂-it në atmosferë’.

⁴⁴ PNAS, Eutrofizimi i ekosistemeve ujore: Bistabiliteti dhe fosfori i tokës (Eutrophication of aquatic ecosystems: Bistability and soil phosphorus, Qasur në: <https://www.pnas.org/content/102/29/10002>, më 13 mars 2021.

Nga Raporti për Zbatimin e Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit 2018-2020, shihet se zbatimi i SCA është e ndërlikuar ngushtë me shumë sektorë, dhe se zbatueshmëria e saj deri më tani ishte modeste dhe me efekt minimal. Sipas zyrtarëve të MEA, marrë parasysh mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit, dhe zhvillimeve të reja në legjislacionin e BE-së, është paraqitur nevojë që të rishikohet legjislacioni për ajrin.⁴⁵ Sipas tyre, projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja është finalizuar, dhe i njëjti do të dërgohet për miratim sapo të formohet Qeveria.⁴⁶ Megjithatë, sfida mbetet edhe korniza institucionale për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të dala nga SCA (2013-2022), të cilat mbesin në mëshirë të projekteve të donatorëve për të arritur çfarëdo progresi.

Për fund, vet ekzistenca e një strategjie të posaçme që fokusohet në cilësinë e ajrit tregon për rëndësinë që kjo çështje duhet të ketë. Për fat të keq, situata në praktikë ka shkuar vetëm duke u përkeqësuar që nga viti 2013 kur është hartuar SCA. Sektori i energjisë, transportit, industrisë, amvisëria dhe vetëdija e ultë kolektive për ndikimin e ajrit në shëndet dhe mirëqenie të përgjithme janë gjithë faktorë kontribues. Ndërhyrjet e Qeverisë duhet të fokusohen në rishikimin e sanksioneve në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar nga OE-të për të siguruar që emetuesit e mëdhenj do të i reduktojnë emetimet dhe do të jenë në përputhje me standardet e mjedisit.

⁴⁵ Komunikim me Albana Kashtanjeva Bytyçi, Zyrtare për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, Divizioni për menaxhimin e mbrojtjes industriale, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

⁴⁶ Ibid.

PËRFUNDIMET E ANALIZËS

- Formatet e ndryshme të pesë Strategjive të analizuara pamundësojnë krahasimin e duhur për kategori të njejë. Në këtë drejtim, standardizimi i formatit të strategjive nga ana e Qeverisë së Kosovës vije si lajm i mirë. Një gjë e tillë me gjasë do të adresojë edhe mangësitë dhe mospërfshirjen e informatave të rëndësishme që medoemos duhet të përfshihen në dokumente të tilla.
- Në letër, me përjashtime të vogla, gjitha Strategjitë e analizuara janë të vetëdijshme për ndikimin që aktivitetet e parapara kanë në mjedis. Secila Strategji ka të paktën një objektivë specifike që adreson mbrojtjen e mjedisit. Mirëpo, zotimi për mbrojtjen e mjedisit, fillon dhe mbaron në letër. Në disa fusha të caktuara (psh. cilësia e ajrit apo manaxhimi i mbeturinave) situata sa vije dhe përkeqësohet.
- Strategjite e ardhshme duhet të investojnë resurse në analizën e mirëfilltë të gjendjes; të jenë më reale në atë që është e mundur të arrihet, dhe në synimet për periudhën e caktuar; të planifikojnë alokimin e mjeteve të nevojshme për zbatimin e veprimeve që parashihen; dhe të jenë të qëllimshëm dhe strikt në zbatimin dhe monitorimin e veprimeve të parapara.
- Kostot e zbatimit ose mos zbatimit të Strategjive janë gjithnjë vetëm kalkulime financiare. Marrë parasyshë natyrën e sektorëve që janë subjekt i këtyre Strategjive kostoja e ndikimit të sektorit (psh. të energjisë, apo minierave dhe mineraleve) në mjedis dhe në shëndetin e qytetarëve është anashkaluar. Si e tillë, kostoja reale e opcionit të ´mos-bërit asgjë´ është edhe më e lartë se kostoja e intervenimeve.

- Monitorimi i strategjive trajtohet si çështje burokratike e përmbushjes së një raporti, dhe jo si detyrim i vazhdueshëm institucional. Në dritë të përkeqësimit të gjendjes në disa sektor, institucionet përgjegjëse kanë dështuar të marrin veprimet e duhura çoftë për të ndëshkuar keqbërësit, apo për të përmirësuar bashkëpunimin ndër-institucional mes tyre.
- Verzioni final dhe i pastër i Strategjive duhet të publikohet në webfaqen e institucioneve përgjegjëse, së bashku me Anekset përkatëse dhe raportet e monitorimit të zbatimit. Në mungesë të transparencës së tillë, qytetarët janë të privuar nga informata nëse Strategjitë e tilla janë zbatuar, dhe nga llogaridhënja që duhet ta kërkojnë nga institucionet përkatëse.
- Sistemet e mbrojtjes që mbështeten vetëm në zbatimin e ligjit, si mjet i vetmë për zvogëlimin e aktiviteteve të dëmshme për mjedis, nuk mund të jenë efikase sa duhet. Vetëdijësimi i qytetarëve për ndikimin që sektorët e ndryshëm kanë në mjedis - dhe për pasojë në shëndetin dhe mirëqenien e tyre - është parakusht i nevojshëm për trajtim më serioz të mbrojtjes së mjedisit si e mirë e përbashkët.
- Investimet më të mëdha në mbrojtjen e mjedisit kanë ndodhur jo nga buxheti i shtetit, por nga asistenca zhvillimore. Përceptimi se mbrojtja e mjedisit është vetëm kërkesë ndërkombëtare, në masë të madhe ka shkaktuar varësi të financimit të projekteve të tilla kryesisht nga donatorët. Pronësia vendore dhe marrja seriozisht e mjedisit do të matet me alokimin e mjeteve vetanake nga buxheti i Kosovës për projekte të tilla që synojnë mbrojtjen e mjedisit.